

VLORA

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE



KONTRATA SOCIALE

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjimore për Zhvillim



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



+355 4 22 555 14



+355 68 20 59 301



gadc@gadc.org.al



www.popalbania.info



+355 4 22 555 14

Rreth Projektit

Përballja e Ofertave Politike – POP 2019, është një nismë e rrjetit të 11 organizatave të shoqërisë civile shqiptare në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme lokale të 30 Qershorit 2019.

POP 2019 synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët mbi platformat elektorale të partive dhe kandidatëve për kryetarë bashkie, si dhe orientimin e këtyre platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të qytetarëve. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien gjatë zgjedhjeve dhe periudhës pas tyre.

POP është zbatuar suksesshëm gjatë Zgjedhjeve Parlamentare 2013, Zgjedhjeve Lokale të vitit 2015 dhe Zgjedhjeve Parlamentare 2017. Kjo nismë është mbështetur dhe mbështetet nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme, me fonde të Ambasadës Suedeze në Tiranë.

POP 2019 do të organizohet në bashkitë Durrës, Fier, Kamëz, Kukës, Pogradec, Pukë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë aty ku organizatat e rrjetit ushtrojnë veprimtarinë e tyre.

POP 2019 synon:

Të nxisë dialogun mes zgjedhësve dhe kandidatëve, por edhe ndërmjet kandidatëve vetë, duke shërbyer si një platformë diskutimi, ku kandidatët do të mbahen të përgjegjshëm ndaj premtimeve të tyre dhe do të ftohen të nënshkruajnë Kontratën Sociale mes tyre dhe qytetarëve në çdo bashki.

Përmes mjeteve të avokimit / lobimit rrjeti POP 2019 do të përpiqet të arrijë rezultate, duke siguruar që kontratat sociale të mos jenë thjesht një zotim i shkruar, por një angazhim i vazhdueshëm për kryetarët e ardhshëm të bashkive.

Të informojnë qytetarët duke përdorur mediat sociale në lidhje me premtimet dhe përparësitë e kandidatëve dhe partive politike përkatëse si dhe në lidhje me punën që do të kryejnë të zgjedhurit për t'i përbushur ato. Përveç kësaj, faqja online interaktive, do t'u ofrojë qytetarëve shqiptarë një paraqitje shumë të nevojshme të ofertave të partive politike. Të rrisë transparencën dhe llogaridhënien e të zgjedhurve gjatë fushatës elektorale, por edhe gjatë mandatit.

Aktivitetet që do të organizohen në kuadër të POP 2019, ofrojnë mundësi të paanshme dhe të barabarta për të gjitha palët dhe kandidatët në dhënien dhe paraqitjen e objektivave dhe platformave të tyre politike për qytetarët. Diskutimet midis kandidatëve nga parti të ndryshme nxisin politikanët të komunikojnë në mënyrë qytetare me njëri-tjetrin dhe synojnë të japin një shembull të mirë për publikun e gjerë në lidhje me kuptimin dhe mbështetjen që politikanët i ofrojnë komuniteteve të tyre pavarësisht bindjeve politike.

Në qendër të të gjitha aktiviteteve të POP 2019 do të jenë qytetarët me nevojat dhe shqetësimet e tyre, pasi zhvendosja e debatit publik nga politika drejt platformave politike në periudhën parazgjedhore është e rëndësishme. POP 2019 është një mundësi për partitë politike që të paraqesin programet e tyre të tregojnë se sa do të kujdesen për qytetarët në katër vitet e ardhshme. Premtimet e partive politike dhe programet e tyre do të monitorohen pas Zgjedhjeve Lokale 2019 nga Rrjeti i organizatave të POP 2019 dhe grupet e qytetarëve që do të organizohen nga ky rrjet.

ORGANIZATAT

- | | |
|--|--|
| • Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë | • Intelktualët e Rinj "Shpresë", Shkodër |
| • Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës | • Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë |
| • Qendra Rinore Vlorë | • Qendra Rinore për Progres, Kukës |
| • ACPD/Qendra "Aulona", Vlorë | • Integrimi, Aktivizimi dhe Ndërgjegjësimi i të Rinjve, Pogradec |
| • Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz | • Lëvizja "Mjaft" |
| • Epoka e Re, Fier | |

PROCESI I FORMULIMIT TË PRIORITETEVE

6 Forume me banorë të rajoneve të qytetit të Vlorës, Novoselës, Orikumit, Qendër dhe Shushicës u realizuan në mars 2019 me qëllim diskutimin e çështjeve me interes për komunitetet lokale, si dhe identifikimin e prioriteteve të zhvillimit vendor në këndvështrimin qytetar. Në secilin prej Forumeve u përfshinë qytetarë të grup-moshave dhe gjinive të ndryshme, të punësuar dhe të papunë, me niveleve të ndryshme arsimore, si dhe individë që u përkasin kategorive në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror.

Pjesëmarrja sipas gjinive

Burra 25 %

Gra 75 %

Në çdonjërin prej forumeve të zhvilluara qytetarët diskutuan gjerësisht mbi 26 çështje që përfshihen në katër fusha kryesore që ndikojnë drejtpërdrejtë mbi komunitetin vendor:



Shërbimet publike



Zhvillimi ekonomik vendor



Dimensioni social




Demokracia vendore

Për secilën prej 26 çështjeve objekt diskutimi ata dhanë këndvështrimin e tyre mbi gjendjen aktuale, si dhe diskutuan mbi prioritetet që në këndvështrimin e tyre duhet të përfshihen në axhendën e të zgjedhurve vendor.

Mbi bazën e vlerësimit të vetë pjesëmarrësve prioritetet e komunitetit u organizuan në dy grupe:

1. **Ndërhyrje prioritare**, ku përfshihen çështjet që në këndvështrimin e komunitetit janë shumë të rëndësishme për ta dhe kërkojnë më shumë angazhim në vijim nga të zgjedhurit vendorë;
2. **Ndërhyrje disi prioritare**, që përfshijnë ato çështje që janë më pak të rëndësishme krahasuar me grupin e parë;



32 prioritete të formuluara dhe të listuara sipas shkallës së rëndësisë nga vetë komuniteti prezantohen gjerësisht në vijim dhe që për përmbushjen e tyre do të llobohet me të zgjedhurit vendorë. Përmbushja e këtyre prioriteteve në praktikë do të monitorohet në vijim nga vetë komuniteti.

PRIORITETET E KOMUNITETIT

● Grupi i parë / NDËRHYRJE PRIORITARE ●

Janë **18 çështje** për të cilat komuniteti ka vlerësuar se janë shumë prioritare.

ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR



- Nxitja e bizneseve të të rinjve dhe grave
- Nxitja e punësimit
- Incentivat për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës
- Programe për mbështetjen e fermerëve
- Njoftimi i qytetarëve mbi detyrimin për taksat/tarifat
- Niveli i taksave tarifave në raport me shërbimin

SHËRBIMET PUBLIKE



- Cilësia e kanalizimeve
- Ndriçimi
- Transporti publik
- Infrastrukturë, rrugë dhe trotuare
- Pyjet dhe kullotat
- Pastrimi

DIMENSIONI SOCIAL



- Romët dhe egjiptianët
- Programe dhe shërbime për individët në nevojë
- Programe dhe shërbime mbi adresimin e dhunës në familje
- Pjesëmarrja e grave në vendimarrje

DEMOKRACIA VENDORE



- Pjesëmarrja në vendimarrje
- Transparenca në vendimarrje

● Grupi i dytë / NDËRHYRJE DISI PRIORITARE ●

Për **8 çështje** pjesëmarrësit në Forume vlerësuan se kërkohen ndërhyrje disi prioritare nga Bashkia.

DEMOKRACIA VENDORE



- Informimi dhe komunikimi

SHËRBIMET PUBLIKE



- Gjelbërimi
- Kanalet kulluese dhe vaditëse
- Shkollat
- Furnizimi me ujë të pijshëm
- Kopshet dhe çerdhet

ZHVILLIMI EKONOMIK



- Pagesa e taksave nga qytetarët
- Shërbimi veterinar



● ZHVILLIMI EKONOMIK VENDOR ●

NXITJA E BIZNESEVE TË TË RINJVE DHE GRAVE

Pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të qytetit të Vlorës nuk ishin në dijeni të egzistencës së programeve specifike të Bashkisë që nxisin biznese të të rinjve apo grave. Madje në këndvështrimin e tyre vetë Bashkia nuk e konsideron punësimin e të rinjve si një detyrë të saj, por si detyrë të Zyrës së Punës. Në këndvështrimin e pjesëmarrësve *"Edhe pse industria e turizmit është një sektor që është shumë i zhvilluar në Vlorë, Bashkia jep pak mundësi për pjesëmarrjen në panaire, afatet e vendosura nuk mjaftojnë dhe nuk ndihmojnë promovimin e bizneseve të të rinjve sidomos në fushën e turizmit". Të rinjtë në forume u shprehën se "nuk shikojmë mundësi për të rinjtë që ndërmarrin inisiativa biznesi, pasi duhen shumë lekë paraprakisht dhe punonjësit e taksave të vijnë që ditën e parë kur hap biznesin".*

Prioritet 1. Zhvillimi i programeve që nxisin krijimin e bizneseve nga të rinjtë dhe gratë.

NXITJA E PUNËSIMIT

Pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të qytetit të Vlorës nuk ishin të informuar për egzistencën e programeve specifike të zhvilluara nga Bashkia për nxitjen e punësimit dhe as të egzistencës së një strukture specifike në Bashki të angazhuar për këtë çështje. Në këndvështrimin e tyre gratë dhe të rinjtë duhet të mbështeten nga Bashkia me programe që nxisin punësimin e tyre. Pjesëmarrësit vlerësuan iniciativën më të fundit për të ngritur "SetturLab", që do të jetë një laborator për trajnimin e të rinjve për punësim në sektorin e turizmit. Laboratori nuk është bërë ende i aksesueshëm për të rinjtë e qytetit, por është një lajm i mirë dhe një projekt që duhet të pasohet nga zhvillimi i programeve të mirëfillta dhe të qëndrueshme të Bashkisë për nxitjen e punësimit të të rinjve dhe grave në veçanti.

Prioritet 2. Programet e Bashkisë për nxitjen e punësimit të priorizojnë grupet më pak të avantazuara në tregun e punës dhe në fokus të veçantë të kenë gratë dhe të rinjtë

INCENTIVAT PËR NXITJEN E BIZNESIT DHE KRIJIMIN E VENDEVE TË REJA TË PUNËS

"Nuk kemi dijeni për incentiva për nxitjen e biznesit, madje shohim më shumë pengesa dhe probleme se sa lehtësi." Si pengesë ata shohin kryesisht taksat e larta, që në këndvështrimin e tyre i bëjnë bizneset të ulin numrin e punonjësve apo të marrin punonjës që punojnë pa siguracione. Ndërkohë ka kompani që janë duke bërë investime në territor, që pjesën më të madhe të punonjësve e gjejnë nga qytete të tjera.

Prioritet 3. Zhvillimi i incentivave për nxitjen e biznesit dhe krijimin e vendeve të reja të punës

PROGRAME PËR MBËSHTETJEN E FERMERËVE

Në tre njësitë administrative Novoselë, Qendër dhe Shushicë shërbim këshillimi për bujqësinë ofrohet, kryesisht nga Drejtoria Rajonale e Bujqësisë dhe AGRO Pika, ndërkohë që institucioni i bashkisë ka në çdo Njësi Administrative një punonjës (agronom) që merret me përgatitjen e dokumentacionit për procesin e A.M.T-ve në pronësi për tokën bujqësore në përdorim. Banorët shprehen se u mungojnë informacionet dhe zvarritjet e procesit të kalimit në pronësi nuk u japin mundësi të ndërmarrin iniciativa lokale që promovojnë zhvillimin ekonomik dhe kryesisht fermerët nuk shfaqin interes për shërbime mbështetëse që qeverisja qendrore apo lokale vë në dispozicion të tyre. Ndërsa në Orikum, banorët shprehen se nuk ofrohet shërbim këshillimi për bujqësinë.

Prioritet 4. Zhvillim i programeve për mbështetjen e fermerëve, si dhe përfundim i procesit të menaxhimit të tokave

NJOFTIMI I QYTETARËVE MBI DETYRIMIN PËR TAKSAT/TARIFAT

Në forumet e rajoneve të qytetit Vlorë pjesëmarrësit u shprehën se merrnin njoftim në banesë për detyrimin për taksat/tarifat. Në njësitë administrative banorët nuk marrin njoftim në banesë.

Prioritet 5. Ngritja e një sistemi të unifikuar që mundëson marrjen e njoftimit në banesë mbi detyrimin për taksat/tarifat

NIVELI I TAKSAVE/TARIFAVE NË RAPORT ME SHËRBIMIN

Vlerësimi i përgjithshëm në forumet e rajoneve të qytetit Vlorë është se taksat janë shumë të larta në raport me shërbimin për të cilin janë destinuar. "Paguhet një taksë gjelbërimi kur në shumicën e lagjeve nuk ka gjelbërim dhe akoma nuk janë bërë ndërhyrje as për asfaltim"- u theksua në Forume. Në Forumet e njësive administrative Novoselë, Orikum, Qendër dhe Shushicë banorët gjithashtu vlerësuan se *"paguajnë taksë për ndriçimin, kanalizimet, gjelbërimin, pastrimin, por janë shërbime që nuk u ofrohen qytetarëve"*¹. Në tërësi ata mendojnë se *"në këto 20 vjet Bashkia nuk ka patur buxhet për investime apo shërbime në zonat rurale"*².

Prioritet 6. Rivlerësim i nivelit të taksave dhe tarifave vendore përmes një procesi konsultues me banorët.

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

CILËSIA E KANALIZIMEVE

Pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të qytetit Vlorë vlerësuan investimet e kryera nga Bashkia të cilat kanë zgjidhur problematikën e mbartur prej vitesh të kanalizimeve në brendësi të qytetit. *"Kanalizimet kanë pasur përmirësime sidomos pas investimit në sistemin e rrjetëzimit të ujrave të bardha dhe të zeza, si dhe me pastrimin e kanaleve të qytetit vitet e fundit"* - u shprehën ata. Ndërkohë konsideruan të rëndësishëm që ky proces të vazhdojë në zonat informale të qytetit, si dhe me vendosjen në funksion të impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit, në mënyrë që të mos ketë më asnjë derdhje të ujrave të zeza në det.

Në njësitë administrative Novoselë, Orikum, Qendër dhe Shushicë pjesëmarrësit në forum u shprehën të pakënaqur lidhur me kanalizimet për ujërat e zeza. Ato mungojnë dhe shpeshherë banorët i derdhen në rrugë ujërat e zeza apo të bardha dhe asnjë masë/gjobë nuk merret nga Bashkia. Situata në Nj.A Qendër dhe Shushicë, paraqitet shumë më problematike në lidhje me kanalizimet, fshatra të tëra të këtyre njësië janë pa sistem kanalizimesh, ose tejet të amortizuara ndërkohë në Novoselë pjesëmarrësit theksuan se *"kanalizimet funksionojnë me gropa septike dhe ka persona që i lidhin gropat me kanalin dhe kjo sjell ndotje të madhe"*. Në mënyrë të veçantë theksuan se kërkohet ndërhyrje e menjëherëshme në fshatrat Mifol dhe Akerni sepse sistemet e kanalizimit e ujërave të bardha dhe të zeza janë të lidhura bashkë me tubacionet e ujit të pijshëm.

Prioritet 7. Përmirësim të cilësisë së kanalizimeve në secilën prej njësië vijuese :

Rajonet e qytetit Vlorë. Kryerje e investimeve në rrjetin e kanalizimeve në zonat periferike dhe vënia në funksion e impiantit të përpunimit të ujrave të zeza në zonën e bregdetit.

Novoselë, Orikum, Qendër dhe Shushicë. Ndërhyrje në sistemin e kanalizimeve, me prioritet në Njësinë Administrative Qendër dhe Shushicë dhe në zonat ku kanalizimet funksionojnë me gropa septike, si dhe specifikisht në fshatrat Mifol dhe Akerni.

NDRIÇIMI

"Kur kujtojmë Vlorën pa drita edhe në rrugët kryesore mendojmë se përmirësimi është shumë i madh. Rruga "Transballkanike" dhe "Lungo Mare" të ndriçuara i kanë dhënë tjetër fytyrë qytetit. Zona të tëra banimi janë ndriçuar dhe nevojitet dhe mirëmbajtje nga vetë qytetarët." theksuan pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të

qytetit Vlorë. Gjithsesi ka ende zona banimi që kanë nevojë për ndriçim, si zona pas kinemasë verore në "Lungo Mare", tek lagjia "Pavarësia", në zonat e brendshme të lagjeve në rrugën e unazës së re, pjesa pas Stadiumit, lagjia "10 korriku", lagjia nga Fabrika e tullave deri në "Pus Mezin", lagjia e fushës së aviacionit, etj.

Në forumin e njësisë administrative Novoselë u theksua se vetëm Novosela ka ndriçim, të gjitha fshatrat e tjera janë pa ndriçim në rrugë. Në Orikum në përgjithësi ndriçimi është i mirë. Një pjesë e shëtitorës nuk ka drita, si dhe në ndonjë lagje në brendësi. Në Dukat ka lagje që janë pa ndriçim. Në Njësinë Administrative Qendër mungesa e ndriçimit të brendshëm në fshatra është një shqetësim i komunitetit, sidomos i grave dhe vajzave. Ndriçimi mungon në të gjitha fshatrat përveç Nartës, Sherishtës, Kaninës dhe Babicës së Madhe. Gjithashtu në Shushicë u theksua se ndriçimi mungon edhe në rrugën kryesore Shushicë dhe pothuajse në të gjitha fshatrat.

Prioritet 8. Përmirësim i ndriçimit sipas njësië vijuese:

Rajonet e qytetit Vlorë. Zona pas kinemasë verore në "Lungo Mare", tek lagjia "Pavarësia", në zonat e brendshme të lagjeve në rrugën e unazës së re, pjesa pas Stadiumit, lagjia "10 korriku", lagjia nga Fabrika e tullave deri në "Pus Mezin", lagjia e fushës së aviacionit.

Novoselë. Në të gjitha fshatrat e Novoselës.

Orikum. Lagjet në brendësi të Orikumit dhe Dukat.

Qendër. Në të gjitha fshatrat përveç Nartës, Sherishtës, Kaninës dhe Babicës së Madhe.

Shushicë. Në rrugën kryesore Shushicë dhe pothuajse në të gjitha fshatrat.

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

TRANSPORTI PUBLIK

Shërbimi i transportit në njësitë administrative është zgjidhur përmes furgonave të liçensuar. Bashkia nuk e ofron vetë osë nëpërmjet një kompanie të kontraktuar shërbimin e transportit urban. Shqetësimi kryesor i pjesëmarrësve në Forumet e Novoselës, Orikumit, Shushicës dhe Qendër ishte çmimi i lartë i biletës për banorët dhe në mënyrë të veçantë për të moshuarit si dhe për fëmijët që përdorin transport për të shkuar në shkollë. Probleme të tjera specifike në lidhje me transportin u theksuan në: Orikum ku furgonat nuk punojnë pas orës 18.00, sikurse është problem transporti i fëmijëve të shkollës në Dukat; Qendër ku u theksua se ka nevojë për t'u rregulluar transporti për fëmijët e shkollës së Sherishtës; Në Shushicë banorët kërkojnë orare fikse dhe më të shpeshta për furgonët.

Shërbimi i transportit publik në qytet ofrohet vetëm përmes një firme private, të kontraktuar që ofron shërbim në rrugët kryesore të qytetit ndërkohë që lagjet periferike kanë vështirësi në marrjen e këtij shërbimi.

Prioritet 9. Zgjidhje e problemit të transportit për fëmijët e shkollës në Dukat dhe të shkollës së Sherishtës.

Prioritet 10. Orare fikse, linja më të shpeshta transporti dhe rritje e orarit të shërbimit përtej orës 18.00. Shtim i shërbimit të transportit urban edhe në lagjet periferike të qytetit.

Prioritet 11. Krijimi i lehtësive për të përballuar koston e transportit për kategoritë në nevojë, fëmijët e shkollave dhe të moshuarit.

INFRASTRUKTURË, RRUGË DHE TROTUARE

"Në vitet e fundit rrugët kryesore janë përmirësuar ndjeshëm. Qyteti po përjeton investime madhore që kanë zhvilluar ekonominë lokale dhe Vlora është bërë një qytet mjaft cilësor", - theksuan pjesëmarrësit në Forumet e rajoneve të qytetit Vlorë. Në këndvështrimin e tyre "Lungo Mare", Unaza e madhe, rruga "Transballkanike", rruga e plazhit të vjetër drejt Pyllit të Sodës dhe bulevardi që po ndërtohet tani, janë investime shumë të rëndësishme që kanë ndryshuar shumë cilësisht qytetin. Megjithatë ka ende zona ku ka nevojë për ndërhyrje, të cilat janë specifikuar tek prioritetet. Në trotualet e lagjeve është e nevojshme që të mbahen në konsideratë kërkesat për aksesin e personave me aftësi të kufizuara, sepse ka trotuare shumë të lartë, sikurse kërkohet vëmendje për gjerësinë e tyre. Ka raste që trotualet janë tepër të ngushtë për këmbësorët si për shembull në Unazën e Madhe në pjesën nga "Bishti i Kalldrëmit" deri në "Ujë të Ftohtë", apo rruga nga Bashkia drejt Spitalit. Kapakët e pushtave

shpesh vidhen dhe zëvendësohen me vonesë nga Bashkia. Mirëmbajtja e sinjalistikës horizontale, si dhe vendosja e sinjalistikës në disa kryqëzime ku ende mungon, u vlerësuan gjithashtu të rëndësishme nga pjesëmarrësit në këto Forume.

Në Forumet e njësive administrative Novoselë dhe Orikum pjesëmarrësit theksuan se rrugët kryesore janë të mira, por ka nevojë për ndërhyrje në rrugët e brendshme në disa fshatra, si dhe të rrugëve që i lidhin me tokat bujqësore. Rrugët ku kërkohet ndërhyrje janë specifikuar tek prioritetet. "Të pakënaqur me cilësinë e rrugëve kryesore dhe të brendshme, si dhe ato që çojnë në tokat bujqësore"- u shprehën pjesëmarrësit në Forumet e njësive administrative Qendër dhe Shushicë. Rrugët ku kërkohet ndërhyrje janë specifikuar tek prioritetet.

Prioritet 12. Vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit, për secilën prej njësive vijuese:

Rajonet e qytetit Vlorë. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugëve ose i blloqeve të brendshme të banimit : Zona tek Fusha e Drurit, rruga tek Tregu i Madh, rruga pas KSHA-së, lagjia pas kopshtit Nr 10, rruga nga fabrika e tullave , rruga nga Porti drejt plazhit të vjetër, rruga "Jani Kosta", rruga dhe e gjithë lagjia pas Stadiumit, rruga tek fusha e aviacionit. Respektim i standarteve në ndërtimin e trotuareve si në këndvështrimin e gjerësisë së tyre, ashtu edhe të garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara. Zëvendësim në kohë sa më të shkurtër të pushtave të vjedhura, si dhe zgjidhje për shmangien e vjedhjeve të tyre. Vendosje e sinjalistikës horizontale dhe vertikale në zonat ku aktualisht mungon.

Novoselë. Ka nevojë për ndërhyrje urgjente në rrugët kryesore në fshatrat: Trevllazër, Cerkovinë, Skroftinë, si dhe rruga e varrezave Cerkovinë. Nevojitet ndërhyrje në rrugët e brendshme në të gjitha fshatrat, si dhe në rrugët për të shkuar në tokat bujqësore. Nevojë për rikonstruksion të rrugës së vjetër kombëtare që lidh fshatrat me njëra-tjetrën.

Orikum. I nevojshëm rikonstruksioni i rrugës tek Kisha e Marmiroit, rrugës buzë detit, rrëza e kanalit Dukat, rrugët e brendshme në Tragjas. Zgjerim i rrugëve të Radhimës dhe të Thilpetit. Në Dukat fshat nevojitet rikonstruksion i rrugës në lagjen Maruke.

Qendër. Kërkohet ndërhyrje urgjente në rrugët e Bestrovës, Kërkovës, Hoshtimës, Sherishtës, Babicë e Vogël dhe Xhyherinës.

Shushicë. Kërkohet rikonstruksion i rrugës Shushicë-Beshisht, rrugës së varrezave në fshatin Drithas dhe rrugës kryesore në Shushicë.

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

PYJET DHE KULLOTAT

Mungesa e kullotave u theksua në forumet e njësive administrative Shushicë dhe Qendër, ndërkohë që në Novoselë pjesëtarët në Forum u shprehën se marrin toka me qera për kullotat e bagëtive, por ka zona ku autostrada i ka bllokuar kalimin për në kullota.

Zjarret u raportuan problem vetëm në Forumin e njësive administrative Orikum, ku pjesëmarrësit theksuan nevojën e vendosjes së penalteteve për zjarrëvënës, ndërsa në njësitë e tjera pjesëmarrësit ishin të kënaqur me masat parandaluese ndaj zjarreve të marra nga Prefektura, Bashkia dhe njësia administrative.

Prioritet 13. Marrja e masave parandaluese ndaj zjarreve në njësinë administrative Orikum.

PASTRIMI

Në forumet e rajoneve të qytetit të Vlorës situatën e pastrimit e vlerësojnë shumë më të përmirësuar krahasuar me vite më parë, megjithatë pjesëmarrësit në forume mendojnë se ka ende nevojë për përmirësim. Shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave në disa zona të qytetit, veçanërisht gjatë sezonit turistik, monitorimi më i mirë i pastrimit të firmave kontraktore veçanërisht në zonat ku infrastruktura rrugore nuk është shumë e mirë, largimi i inerteve në disa lagje ku janë kryer punime, si dhe eliminimi i plotë i djegies së plehrave në pak zona ku vijon ky problem, u konsideruan si të rëndësishme nga pjesëmarrësit në forume. Gjithashtu pjesëmarrësit në forume kishin djeni që është duke u ngritur vend-depozitimi i ri i mbetjeve urbane në Sherishtë, Qendër, por ai nuk është vënë në funksion ende.

Pjesëmarrësit në forumet e Novoselës dhe të Orikumit janë shprehur përgjithësisht të kënaqur me cilësinë e pastrimit, por theksojnë se është i nevojshëm shtimi i koshave për mbledhjen e mbeturinave. Në Orikum problem u konstatua me djegien e plehrave që sipas pjesëmarrësve vazhdojnë të digjen buzë lumit dhe përhapin tymin kudo. Për pjesëmarrësit në Forumin e Njësive Administrative Qendër pastrimi mbetet një problem shumë i mprehtë. Në fshatra nuk ka vende grumbullimi për mbeturinat, mungojnë kontenitorët dhe mbeturinat hidhen rrugëve. Në disa fshatra si Hoshtimë, Bestrovë nuk ka shkuar asnjëherë makina për mbledhjen e mbeturinave. Në Babicën e Madhe mbeturinat mbledhen në një vend të dukshëm anës rrugës kryesore dhe sjellin ndotje të mjedisit dhe shëndetit të popullatës.

Të pakënaqur me cilësinë e pastrimit u shprehën edhe pjesëmarrësit në forumin e njësive administrative Shushicë. Ka nevojë urgjente për shtimin e koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.

Prioritet 14. Të vihet në funksion impianti i vend-depozitimit të mbeturinave në Sherishtë. Përmirësim i cilësisë së pastrimit sipas nevojave të secilës njësi:

Rajonet e qytetit Vlorë. Shtimi i punonjësve të pastrimit dhe shtimi i koshave në disa zona të qytetit, sidomos gjatë sezonit turistik. Pastrim nga inertet në rrugët ku ka pasur rikonstrukcion (p.sh rruga "Shyqyri Alimerko"). Në pjesën e "Lungo Mares" i domosdoshëm shtimi i koshave sidomos në rrugët dytësore që dalin në të. Bashkia të monitorojë punën e firmës kontraktore të pastrimit, pasi ka lagje ku makina shkon vetëm një herë në javë (shembull lagja "10 korriku"). Të shtohen masat e kontrollit të Bashkisë në zonat ku banorët bëjnë djegie të mbetjeve kryesisht plastikave, veçanërisht në ish-fushën e druve dhe ish-fushën e aviacionit.

Novoselë. Vendosja e koshave për mbledhjen e mbeturinave në çdo fshat. Nevojitet të shtohen 140 kosha të tjerë.

Orikum. Vendosje e koshave në lagjet brenda fshatrave dhe dizinfektimi i koshave egzistues. Eliminimi i plotë i djegies së mbeturinave.

Qendër Vlorë. Bashkia të kontraktojë firmë pastrimi ose nëpërmjet Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike të vendosë kosha për mbledhjen e mbeturinave në të gjitha fshatrat. Mbledhja sistematike e mbeturinave nga makinat e pastrimit në të gjitha fshatrat e kësaj njësie.

Shushicë. Urgjente shtimin i koshave të mbetjeve në të gjithë njësinë. Prioritet pastrimi në fshatrat Risili, Çeprat, Mekat, Bunavi, Beshisht dhe Drithas.

DIMENSIONI SOCIAL

ROMËT DHE EGJIPTIANËT

Mungesa e informimit mbi punën e Bashkisë për integrimin dhe fuqizimin e komunitetit rom dhe egjiptian ishte e dukshme jo vetëm në forumet e njësive ku nuk ka komunitet romë dhe egjiptian, por edhe në njësitë ku jeton ky komunitet. Në të gjitha forumet u theksua nevoja që Bashkia të zhvillojë programe që nxisin në mënyrë të veçantë punësimin dhe strehimin e familjeve dhe individëve më në nevojë pjesë e këtij komuniteti.

Prioritet 15. Trajtim më prioritet i programeve që nxisin strehimin dhe integrimin në punë të komunitetit rom.

PROGRAME DHE SHËRBIME PËR INDIVIDËT NË NEVOJË

Në të dy forumet e zhvilluara në rajonet e qytetit të Vlorës pjesëmarrësit ishin të informuar mbi egzistencën e disa shërbimeve të kujdesit shoqëror që funksionojnë në territorin e Bashkisë, por ata u shprehën se nevojat për këto shërbime janë shumë më të mëdha. Në këndvështrimin e tyre Bashkia duhet të mbështesë me shërbime kategori të ndryshme në rrezik dhe me prioritet të ndërtojë shërbime psikologjike dhe aftësimi për jetën për të rinjtë, pasi rastet e dhunës, bullizmit dhe përdorimit të drogave janë rritur.

Në njësitë administrative Novoselë, Orikum, Qendër dhe Shushicë u theksua mungesa e plotë e shërbimeve për kategoritë në nevojë në territorin e njësive ku ata banojnë. *"Familjet kanë shumë probleme sociale të cilat duhen adresuar në kohë dhe jo të merren masa vetëm atëherë kur familja është prishur për shkak të dhunës apo problemeve të tjera ekonomiko-sociale"*.

Në mënyrë të veçantë në forumet e këtyre njësive administrative u theksua mungesa e shërbimeve në familje për personat me aftësi të kufizuara, si dhe e shërbimeve psikologjike për viktimat e dhunës në familje, të cilat edhe pse egzistojnë në fakt janë shumë larg nga vendbanimet e tyre. Pjesëmarrësit në këto Forume vlerësuan vendimet e Bashkisë për të mbështetur viktimat e dhunës në familje duke ofruar shërbime pa pagesë për kopshtet dhe çerdhet e fëmijëve, por në zonat larg qytetit mungesa e kopshteve dhe çerdheve e bën këtë vendim të panevojshëm.

Ata vlerësuan gjithashtu edhe mbështetjen që u jepet grave në zonat larg qytetit duke u ofruar transportin falas me qëllim ndjekjen e kurseve profesionale në qytetin e Vlorës.

Prioritet 16. Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe në mënyrë të veçantë:

Rajonet e qytetit Vlorë. Shërbime psikologjike dhe aftësimi për jetën për të rinjtë. Shërbime për reabilitimin nga përdorimi drogës dhe alkoolit.

Novoselë, Orikum, Qendër Vlorë dhe Shushicë. Shërbime në familje për personat me aftësi të kufizuara, si dhe shërbime psikologjike e mbështetëse për viktimat e dhunës në familje.

PROGRAME DHE SHËRBIME MBI ADRESIMIN E DHUNËS NË FAMILJE

Fushatat e informimit mbi dhunën në familje të ndërmarra në mënyrë të koordinuar nga shoqëria civile dhe Bashkia kanë pasur efektet e tyre jo vetëm në rajonet e qytetit të Vlorës, por edhe në njësitë administrative. Pjesëmarrësit në Forume edhe pse nuk njihnin saktësisht programet që zbaton Bashkia ishin të informuar se ku mund të denoncojnë rastet e dhunës. Megjithatë ata u shprehën për një angazhim më të madh të Bashkisë në vijim. *"Banoret gra viktimat e dhunës në familje ndihen të dhunuara në familje dhe të braktisura nga Bashkia. Gruaja konsiderohet pronë e burrit dhe nuk ka mbështetje kundër dhunës"*.⁴ Ngritjen e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje pjesëmarrësit në Forume e konsideruan prioritare. *"Mendojmë se përveç OJF-ve në qytet duhet të ketë më shumë programe për adresimin e dhunës dhe të shtohet mbështetja e Bashkisë për rritjen e kapaciteteve për të ndihmuar viktimat e dhunës. Duhet parë me prioritet të ndihmohet çdo person që merr urdhër mbrojtje, duke ofruar dhe bonus strehimi dhe mbështetje financiare"*.⁵

Prioritet 17. Zgjerim i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese që targetojnë komunitetin mbi dhunën në familje dhe pasojat e saj.

Prioritet 18. Rritje e identifikimit të rasteve të dhunës në familje përmes punës proaktive në komunitet, në çdo njësi administrative, të strukturave të shërbimeve sociale.

Prioritet 19. Zgjerim i shërbimeve egzistuese mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruese për viktimat e dhunës në familje.

³ Forum njësia administrative Orikum

⁴ Forum njësia administrative Novoselë.

⁵ Forum rajon i qytetit të Vlorës

● DEMOKRACIA VENDORE ●

PJESËMARRJA E GRAVE NË VENDIMARRJE

Këshilli bashkiak ngrihet mbi bazën e përqindjeve që marrin partitë politike në zgjedhjet lokale dhe niveli i përfshirjes së grave në këtë strukturë vendimarrëse përcaktohet nga pozicioni i tyre në këto lista. Mungesa e komunikimit të drejtëpërdrejtë të këshilltarëve me komunitetin pas zgjedhjeve lokale e bën të vështirë për komunitetin të vlerësojë se si është përfaqësimi i grave në këshill, si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor. Pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të Vlorës për arsyt e lartpërmendura nuk mund të vlerësojnë nivelin e pjesëmarrjes së grave në këshill Bashkiak. Në Forumet e njësive administrative Orikum dhe Qendër u theksua se nuk ka asnjë grua në këshill bashkiak, banore në këto njësi, ndërkohë që në dy njësitë e tjera ka përfaqësim të grave banore të këtyre njësive në këshill bashkiak. Në të gjitha forumet u theksua nevoja që të ketë përfaqësim sasior dhe cilësor të grave në vendimarrjet lokale.

Prioritet 20. Programe ndërgjegjësuëse që nxisin rritjen e pjesëmarrjes së gruas në vendimarrje.

PJESËMARRJA E KOMUNITETIT NË VENDIMARRJE

Bashkia e Vlorës zhvillon konsultime publike, por pjesëmarrësit në forumet e zhvilluara theksojnë se ato janë të pamjaftueshme dhe jo tërësisht efektive. Në rajonet e qytetit të Vlorës pjesëmarrësit ishin të informuar mbi dëgjuesat që zhvillon Bashkia në lidhje me buxhetin. Asnjë nga pjesëmarrësit nuk është përfshirë në këto dëgjesa pasi nuk ka marrë njoftim, thjesht janë informuar nga media apo rrjetet sociale pasi dëgjuesat kanë përfunduar. Rezerva në lidhje me njoftimin për pjesëmarrje në dëgjesa apo konsultime publike shprehën edhe pjesëmarrësit në forumet e njësive administrative, sikurse shprehën nevojën për të zhvilluar konsultime e dëgjesa më shpesh dhe jo vetëm për miratimin e buxhetit. *"Të bëhen më shpesh jo vetëm dy herë në vit. Duhet të mblidhet komuniteti, jo vetëm administrata dhe kryepleqtë të cilët thirren sa herë që bëhen konsultimet publike për buxhetin"*.

Një tjetër shqetësim i shprehur në forumet e njësive administrative është ai i produktit të konsultimeve. Edhe kur marrin pjesë në dëgjesa nuk ndjejnë që kërkesat e tyre janë marrë në konsideratë nga vendimarrësit e Bashkisë. *"Ndihe mi të lënë pas dore, përse kohë që nuk janë bërë investime në zonën tonë"*. Megjithatë pjesëmarrësit në forume nuk e shohin çështjen e pjesëmarrjes së komunitetit në vendimarrje vetëm si përgjegjësi të Bashkisë, por edhe të vetë qytetarëve.

"Ne vetë duhet të jemi më aktiv, sepse edhe kur bëhen konsultime nga Bashkia nuk ka zëra nga komuniteti për të kërkuar zgjidhje apo për të dhënë alternativa për zgjidhjen e problemeve".

Prioritet 21. Bashkia të ndërtojë mekanizma të unifikuar dhe efektiv (Buxhetimi me Pjesëmarrje) për të marrë këndvështrimin e komunitetit mbi vendimarrjet më të rëndësishme, duke:

- mos u limituar vetëm tek konsultimi i buxhetit,
- përdorur edhe forma të tjera konsultimi përveç takimeve me komunitetin, si dhe duke rritur numrin e takimeve konsultuese
- mundësuar përfshirjen e gjerë të komunitetit në këto procese
- raportuar sistematikisht në komunitetet se sa prej mendimeve të komunitetit janë reflektuar në vendimarrjet e saj.

Prioritet 22. Të krijohet Bordi /Këshilli Rinor për të rritur pjesëmarrjen e të rinjve në vendimarrjen lokale.

TRANSPARENCA NË VENDIMARRJE

Bashkia e Vlorës ka një faqe në internet si një mjet për të bërë transparent aktivitetin e saj, por kjo faqe nuk përditësohet vazhdimisht dhe jo çdo informacion të nevojshëm e gjen në të, u theksua në forumet e rajoneve të qytetit të Vlorës. Në njësitë administrative informimi mbi vendimarrjet e Bashkisë bëhet kryesisht përmes këndit për shpalljen e njoftimeve publike dhe të tilla ka në çdo njësi. Media lokale dhe mediat sociale janë një tjetër rrugë për të marrë informacion mbi vendimet që merren në Bashki.

Prioritet 23. Zhvillimi i mekanizmave që mbajnë në konsideratë mundësitë e komuniteteve për ta marrë informacionin dhe që mundësojnë transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak

● SHËRBIMET PUBLIKE ●

GJELBËRIMI

Zgjerimi i hapësirave të gjelbërta në qytetin e Vlorës u konsiderua shumë i rëndësishëm nga pjesëmarrësit e forumeve të rajoneve të këtij qyteti. Pjesëmarrësit vlerësuan se investimet madhore të viteve të fundit kanë ndihmuar dhe në zgjerimin e sipërfaqeve të gjelbërta, por nuk janë të mjaftueshme. *"Më shumë gjelbërim dhe më pak beton"*- kërkuar pjesëmarrësit në forume. Ata konsiderojnë të rëndësishëm ndërhyrje për gjelbërim në rrugët dytësore të qytetit, mirëmbajtjen e pemëve në blloqet e banimit, pasi mungesa e mirëmbajtjes po sjell tharjen dhe dëmtimin e tyre në disa zona, si dhe ngritjen e një parku në qytet.

Prioritet 24. Vijimi i zgjerimit të hapësirave të gjelbërta dhe veçanërisht ndërhyrje për gjelbërim në rrugët dytësore të qytetit, mirëmbajtjen e pemëve në blloqet e banimit, ngritje e një parku në qytet.

KANALET KULLUESE DHE VADITËSE

Konstatohet vëmendje e shtuar e Bashkisë për pastrimin e kanaleve kulluese. Në Forumin e Novoselës u theksua se në vitet e fundit 50% e kanaleve kulluese janë pastruar, duke përfshirë kanalin kryesor dhe sekondar. Në Qendër janë kryer pastrimet e kanaleve në Bestrovë, Kerkovë, Panaja, Sherishtë, Nartë, Xhyherinë. Në Shushicë është punuar për pastrimin e kanaleve kulluese, por theksohet se në Llakatund kanalet kulluese kanë nevojë për pastrim. Në të gjitha njësitë pjesëmarrësit vlerësuan se Bashkia duhet të vazhdojë punën për pastrimin e kanaleve kulluese. Në Forumin e Orikumit pjesëmarrësit u shprehën me shqetësim për gjendjen e kanaleve kulluese. *"Gjendja e kanaleve kulluese pas mosfunksionimit të Hidrovorit është përkeqësuar, sepse ato nuk kanë ku shkarkojnë. Edhe problemi i kanalit të Kodrës këto vitet e fundit ka dalë, pasi atje janë ndërtuar disa shtëpi dhe ujrat dalin në rrugë. Në lagjen "Maruke" kanalet kulluese i kanë mbjellë me frutikulturë"*- u shprehën ata. Në lidhje me kanalet vaditëse nevojat në njësi të ndryshme rezultojnë të ndryshme. Në Novoselë nuk egzistojnë kanale vaditëse. Në Qendër është ngritur diga në liqen dhe është ndërtuar 6 km kanal për vaditje. Në Shushicë kanalet vaditëse janë sistemuar në shumicën e fshatrave dhe gjendja e tyre është e mirë, por problem është uji për vaditje. Ka shumë pak ujë për vaditje sepse bëhen ndërhyrje të paligjshme dhe ka shpërndarje të pabarabartë.

Prioritet 25. Ndërhyrje e menjëherëshme dhe e vazhduar në kanalet kulluese dhe vaditëse:

Orikum. Dizinfektim i kanalit të hidrovorit me qëllim shmangien e mushkonjave. Pastrim i kanaleve kulluese

në të gjithë zonën. Zgjidhje për kanalin në Kodër.

Novoselë, Qendër dhe Shushicë. Vijim i pastrimit të kanaleve kulluese. Zgjidhje e problemit të mungesës së kanaleve vaditëse në Novoselë, si dhe e problemit të ujit për vaditje në Shushicë.

SHKOLLAT

E përbashkëta e të gjitha forumeve të zhvilluara është fakti që pjesëmarrësit kanë vlerësuar punën e Bashkisë me investimet që ka kryer për rikonstruksionin e plotë në një numër shkollash, si në zonën e qytetit ashtu dhe në disa shkolla në njësi administrative. *"Gjithësesi Bashkia duhet të punojë më shumë për mirëmbajtjen e shkollave"*. Në secilin prej Forumeve pjesëmarrësit identifikuan shkollat dhe përmirësimet e nevojshme që duhet të ndërmerren në vazhdim nga Bashkia, të cilat janë specifikuar tek prioritetet.

Prioritet 26. Përmirësime në shkollat egzistuese në secilën prej njësive vijuese:

Rajonet e qytetit të Vlorës. Zgjidhje e problemit të furnizimit me ujë në shkollat *"Halim Xhelo"*, *"Rilindja"*, *"Naim Frashëri"*. Zhvillimi i hapësirave të gjelbërta dhe terreneve sportive në shkollat *"24 Maji"* dhe *"4 Heronjtë"*. Ndërtim i palestrës në shkollën *"Muço Delo"*.

Novoselë. Rikonstruksion për shkollat në *Cerkovinë* dhe *Akërnë*.

Orikum. Rikonstruksion për shkollën në *Dukat*, si dhe rrethim i oborrit të shkollës së mesme në *Orikum*. Ngrohje e shkollave gjatë stinës së dimrit.

Qendër. Rikonstruksion i tualeteve në shkollën e *Babicës* së madhe.

Shushicë. Zgjidhje e problemit të ngrohjes dhe furnizimit me ujë të vazhdueshëm të shkollave.

FURNIZIMI ME UJË TË PIJSHËM

Furnizimi me ujë të pijshëm vijon të jetë problematikë për Bashkinë e Vlorës. Në forumet e qytetit pjesëmarrësit theksuan se situata brenda qytetit është e ndryshme. Ka zona që furnizohen 24 orë me ujë, por ka dhe zona të tjera që ka kufizime në oraret e furnizimit sikurse cilësia e ujit dhe rrjetit furnizues lë për të dëshiruar. Në Novoselë rrjeti i amortizuar krijon probleme me furnizimin me ujë veçanërisht në periudhën e verës. Në Orikum zona më problematike është ajo e Dukatit të Ri dhe Dukat fshat, ndërkohë që sistemi nëpër fshatra është shumë i amortizuar. Përfundimi i investimit në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimeve do të sjellë ndryshim të gjendjes egzistuese. Fshatrat e Qendrës: Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kerkovë dhe Panaja nuk furnizohen me ujë. *Vijon në fq tjetër →*

SHËRBIMET PUBLIKE

Vazhdim → Banorët kërkojnë të ketë një shpërndarje më të drejtë midis fshatrave për shpërndarjen me ujë, sepse ndodh që një fshat ka 8 orë ujë dhe një tjetër gjysëm ore. Gjithashtu cilësia e ujit të pijshëm lë për të dëshiruar. Fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi në Shushicë nuk kanë ujë për shkak të rrjetit të amortizuar. Në fshatrat Drithas dhe Grabian ka ujë, por ka probleme me cilësinë e ujit. Në Grabian depoja e ujit nuk është pastruar prej vitesh dhe në Drithas uji është pothuajse i papijshëm.

Prioritet 27. Adresimi me prioritet i furnizimit me ujë për secilën prej njësive vijuese:

Rajonet e qytetit të Vlorës. Furnizimi me ujë në zonat ku aktualisht ka ujë vetëm një herë në 24 orë. Përmirësim i cilësisë së ujit të pijshëm.

Novoselë. Ndërhyrje në rrjetin e amortizuar që krijon probleme me furnizimin veçanërisht gjatë verës.

Orikum. Me prioritet ndërhyrjet në Dukat të Ri dhe Dukat fshat. Qendër. Furnizim me ujë për fshatrat Bestrovë, Babicë e Vogël, Hoshtimë, Kërkovë dhe Panaja.

Shushicë. Furnizim me ujë për fshatrat Llakatund, Beshisht dhe Bunavi, përmirësim i cilësisë së ujit në Drithas dhe Grabian.

KOPSHTET DHE ÇERDHET

"Kopshtet në pjesën më të madhe kanë pak rikonstruksi-one, nuk kanë sistem ngrohjeje, u mungon baza materiale dhe bashkia duhet të investojë më shumë në këtë fushë. Çerdhe ka shumë më pak dhe shumica e qytetarëve i çojnë fëmijët në çerdhe private"- theksuan pjesëmarrësit në forumet e rajoneve të qytetit Vlorë. Rritja e buxhetit të Bashkisë të destinuar për kopshtet dhe çerdhet, sikurse ngritja e kopshteve dhe çerdheve të reja duhet të konsiderohen si një nga çështjet prioritare për Bashkinë Vlorë. Në njësitë administrative Novoselë, Orikum, Qendër dhe Shushicë pjesëmarrësit vlerësuan se kopshtet janë në gjendje normale dhe funksionojnë. Të vetmet kërkesa të tyre lidhen me mirëmbajtjen e kopshtit të Rradhimës, përmirësimi i pajisjeve të brendshme të kopshtit në Shushicë dhe ngritja e një çerdheje në Alikokë. Edhe pse mungojnë çerdhet në këto njësi administrative pjesëmarrësit në forume nuk e konsideruan të rëndësishme ngritjen e tyre.

Prioritet 28. Rikonstrukcion i kopshteve dhe çerdheve egzistuese në qytetin e Vlorës, përmirësim i kopshtit në Shushicë dhe ngritja e një çerdheje në Alikokë.

DEMOKRACIA VENDORE

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Rrugët për të marrë informacionin e nevojshëm janë të ndryshme në terriore të ndryshme. Në forumet e rajoneve të qytetit të Vlorës u theksua se mund ta marrin informacionin online ose edhe në sportelet e Bashkisë. Shqetësim përbën fakti që ka raste që informacioni që marrin nga punonjësit nuk është i saktë, si dhe përgjigjet shpesh vonohen përtej afateve që parashikon ligji për të drejtën e informimit publik. Një njësitë administrative Novoselë, Orikum, Qendër dhe Shushicë informacioni është i aksesueshëm pranë zyrave të njësive

administrative, por për çështjet që nuk janë kompetencë e njësive ata duhet t'i drejtohen Bashkisë.

Prioritet 29. Çdo informacion i nevojshëm për qytetarët të ofrohet në sportelet e njësive administrative, për të shmangur humbjen e kohës së tyre, si dhe kostot e transportit.

Prioritet 30 Çdo informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm nga të gjithë qytetarët, përfshirë personat me aftësi të kufizuara.

ZHVILLIMI EKONOMIK

PAGESA E TAKSAVE NGA QYTETARËT

Në rajonet e qytetit të Vlorës pjesëmarrësit theksuan se taksat paguhen rregullisht, pasi Bashkia aplikon masa në rast të mos pagimit të taksave. Në forumet e njësive administrative rezultoi se taksat nuk paguhen nga të gjithë banorët. Në Novoselë 70 % e banorëve të zonës i paguajnë taksat rregullisht. Në Orikum nuk mbledhen si duhet taksat e plazhit dhe ato të pastimit e ndriçimit. Në Qendër rreth 89 % e bizneseve paguajnë taksat dhe mbi 50% e taksës bujqësore paguhet. Taksa rregjistrohet tek fatura e ujit, por jo i gjithë fshati ka ujë dhe për rrjedhojë taksa e tokës nuk paguhet nga të gjithë. Në Shushicë taksat mbledhen në masën 50-60 %, sikurse dhe në Qendër mungesa e ujit tek të gjithë banorët bën që taksa që rregjistrohet në faturën e ujit të mos paguhet nga të gjithë banorët.

Prioritet 31. Zhvillimi i një mekanizmi efektiv nga Bashkia për mbledhjen e taksave ku të përfshihen edhe fushata informimi e komunikimi me komunitetin mbi mbledhjen dhe rishpërndarjen e tyre

SHËRBIMI VETERINAR

Në forumet e njësive administrative Novoselë, Orikum dhe Qendër pjesëmarrësit theksuan se veterineri merret vetëm me pazarin dhe thertoren dhe nuk ka plan pune. Në Shushicë u shprehën të kënaqur me shërbimin veterinar.

Prioritet 32. Shërbimi veterinar në njësitë Novoselë, Orikum dhe Qendër të jetë më i mirë orientuar drejt nevojave lokale.